

SPORT #WithoutWaste

Rekomandimet e Politikave

për evente sportive bazë të qëndrueshme
dhe pa mbeturina në rajonin e Ballkanit



Tabela e përmbajtjes

- 2** Çfarë është një event sportiv bazë #WithoutWaste?
- 3** PSE nevojiten rekomandime politikash dhe për KË janë ato?
- 4** Rekomandimet e politikave për autoritetet lokale dhe komunat
- 6** Lista me rekomandime
- 14** Rekomandimet e politikave për organizatat e sportit bazë
- 15** Lista me rekomandime
- 20** Frymëzim
- 22** Referenca frymëzuese
- 24** Partnerët



Përdorni këtë simbol për t'u kthyer në tabelën e përmbajtjes



Çfarë është një event sportiv bazë #WithoutWaste?

Eventet sportive bazë #WithoutWaste përfshijnë evente sportive lokale dhe ato të shkallës më të vogël. Kjo është për të dalluar nga eventet më të mëdha masive si Olimpiadat apo Kupa e Botës FIFA. Eventet sportive bazë #WithoutWaste përqendrohen tek organizatat e vogla, OJF-të dhe shkollat që të krijojnë evente sportive që lidhen me komunitetin lokal.

Në kundërshtim me eventet e organizuara profesionalisht në shkallë të madhe, eventet sportive #WithoutWaste shpesh janë të krijuara në mënyrë poshtë-lart nga vullnetarë lokalë që njohin kontekstin lokal, por shpesh nuk kanë trajnim të planifikojnë evente të qëndrueshme apo për përdorimin ciklik të burimeve.

Qëllimi kryesor është reduktimi dhe ripërdorimi i mbeturinave në evente. Koncepti #WithoutWaste përfshin:

- + Sigurimin e mundësive për pjesëmarrjen e njerëzve, infrastrukturës gjatë eventeve sportive (si kosha riciklimi që duken qartë), shfaqjen e informacionit gjatë eventeve në lidhje me riciklimin
- + Trajnimin e stafit dhe të vullnetarëve për të reaguar dhe parandaluar hedhjen e mbeturinave, dhe organizatat të zbatojnë metodologji për 'Krijimin e vendit', për të rritur pronësinë dhe për të kuptuar dhe për tu përshtatur ndaj sfidave lokale
- + Komunikim me pjesëmarrësit mbi përgjegjësinë për riciklim dhe përpjekjet e bëra nga organizatat
- + Bashkëpunim me median për të arritur tek komunitetet dhe për të komunikuar përpjekjet dhe për të shpërndarë me organizata të tjera burimet efikase
- + Krijimin e mundësive të financimit dhe më shumë përvoja në përdorimin e strategjive pa mbeturina (si pjata të ripërdorshme, servise, gota, etj.)

PSE nevojiten rekomandime politikash dhe për KË janë ato?

Koncepti #WithoutWaste mund të jetë i suksesshëm vetëm nëse gjithë komuniteti angazhohet në zhvillimin e eventeve bazë për ndryshime shoqërore dhe mjedisore. Vetëm së bashku, ne mund të bëjmë një dallim.

Ky dokument synon të inspirojë autoritetet lokale, komunat, komunitetet lokale dhe organizatat sportive bazë dhe të lehtësojë përpjekjet si të krijojmë evente të qëndrueshme. Hapi i parë është të konsiderojmë përse është e rëndësishme që njerëzit të mendojnë në një mënyrë të qëndrueshme. Ku mundemi gjatë rrugës të krijojmë vlerë për eventin tonë duke menduar në një mënyrë të qëndrueshme?

Rekomandimet synojnë të ndihmojnë komunitetet të fillojnë organizmin. E dimë që është e pamundur që nga dita e parë të arrijmë tërësisht drejt qëndrueshmërisë, por çdo hap ka rëndësi dhe shpresojmë që rekomandimet e ofruara do të lehtësojnë prioritetet tuaja.

Ne, së bashku duhet të punojmë për të ardhmen tonë të përbashkët.

Rekomandimet e politikave për autoritetet lokale dhe komunat

Sipas Raportit 'Qytetet me Zero Mbeturina', gjatë gjithë vitit 2022 ka pasur një rritje të vazhdueshme në pranimin e strategjive pa mbeturina nga komunat Evropiane, duke përfshirë numrin e angazhimeve të ndërmarra si edhe ndikimin e këtyre strategjive¹.

Sipas artikullit "Politikat Vendore të Eventeve Sportive dhe Qëndrueshmëria: Një qasje e ndërthurur", kërkohet që autoritetet lokale, komunat dhe organizuesit e eventeve sportive të mbështeten në marrëdhënie alternative të quajtur "**politikat për eventet,**"² pra, politika që synojnë të rregullojnë eventet si një shtesë ose duke zëvendësuar modelet aktuale "politikat për eventet", me modele që synojnë të përdorin eventet si një levë.

Edhe pse roli i autoriteteve lokale dhe buxheti që ata caktojnë për sportin dhe aktivitetin fizik ndryshon nga vendi në vend, ende ata kanë një rol të rëndësishëm në sigurimin e sportit komunitar dhe aktivitetit fizik. (Disa vende në Ballkan bëjnë përjashtime ku aktivitetet janë të centralizuara dhe siç ndodh në Hungari ato mbështeten drejtpërdrejt nga qeveria qendrore. Sipas Raportit Eurostat në 2018, pjesa më e madhe e shpenzimeve për rekreacion dhe sport gjendet në Hungari me 2.1% në të gjitha Shtetet Anëtare të BE-së. Kjo ndryshon nga 0.4% e shpenzimeve totale në Bullgari, Irlandë dhe Maltë, deri në 2.1% në Hungari).³

Sistemi i decentralizimit në Ballkanin Perëndimor ndjek parimin e "shpërndarjes simetrike" të përgjegjësiive dhe kompetencave, që do të thotë se të gjitha komunat, pavarësisht

1 <https://zerowastecities.eu/wp-content/uploads/2023/02/State-of-Zero-Waste-Municipalities-Report-2022-EN.pdf>

2 <https://www.frontiersin.org/articles/10.3389/fspor.2021.667762/full#B59>

3 <https://ec.europa.eu/eurostat/web/products-eurostat-news/-/edn-20200923-1>

nga madhësia e tyre kanë statutet e tyre, kompetencat dhe fuqinë për të marrë vendime. Aktivitetet sportive dhe kulturore janë brenda kompetencave të qeverive lokale në shumë vende të Ballkanit Perëndimor, si Maqedonia e Veriut, Serbia, Mali i Zi, Kosova, [Shqipëria](#) etj⁴. Nga parket lokale deri tek qendrat sportive dhe të rekreacionit ato bashkëpunojnë me klube sportive lokale, shkolla dhe organizata që të ofrojnë mundësi për komunitetet lokale për të qenë aktiv dhe për të marrë pjesë në sporte bazë dhe në të gjitha format e rekreacionit.

Nëse punoni në një qeverisje lokale, komunë ose departament që ka lidhje me qëndrueshmërinë në rajonin ku jetoni, ju lutemi shikoni listën e rekomandimeve dhe frymëzimeve më poshtë.



© BG Be Active Association

4 https://issuu.com/kdz_austria/docs/8d3249ad-en (Page 41)

Lista me rekomandime

- **Nevojitet të krijoni një mjedis aktiv:** Vendet ku jetojmë mund të kenë një efekt të konsiderueshëm në shëndetin tonë, sjelljen dhe cilësinë e jetës. Vendet që ofrojnë mundësi për njerëzit të jetojnë një jetë fizike aktive mund të ndikojnë pozitivisht në shëndetin fizik dhe mendor të tyre. Prandaj, krijimi i një mjedisi aktiv me përfshirjen e banorëve dhe qytetarëve duhet të jetë një nga qëllimet kryesore në strategjinë e autoriteteve lokale.



© Federata Shiptare e Sportit Shkollor

- Një pikënisje e mirë është duke caktuar **një oficer qëndrueshmërie** në qeverinë lokale dhe / ose komunën. Kështu, komuniteti lokal vendos përgjegjësinë për masat mjedisore në dispozicion me një apo më shumë individë që mbikqyrin komunitetin dhe zbatimin e iniciativave të gjelbërta.

FRYMËZIM

[Projekti ByKuben](#) në Oslo është një projekt bashkëpunues për komunën, në përputhje me Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm të Kombeve të Bashkuara. Ai kontribuon në komunën e Oslo-s duke realizuar ambiciet e saj për klimën dhe mjedisin dhe synon të bëjë qytetin më të gjelbër duke përfshirë dialog dhe pjesëmarrjen e stafit në udhëzime dhe veprime të drejtpërdrejta.



© Bykuben



- Inkorporoni SDG-të në planet e veprimit të komunave.** SDG-të duhet të jenë bazë për çdo strategji dhe vendim të ardhshëm të autoriteteve lokale dhe komunave. Prandaj është e rëndësishme që SDG-të të përfshihen në planet e veprimit të qeverive lokale dhe komunave. Planet e veprimit gjithashtu duhet të jenë të detajuara dhe të shpjegojnë se si qëllimet e tyre do të ndikojnë në fushat specifike të politikave të eventeve sportive bazë. Edhe pse planet e veprimit të një qeverie lokale ose komune mund të përfshijnë gjerësisht "qëndrueshmëri mjedisore", dhe "evente të gjelbërta", politikat e eventeve nuk duhet të mbeten të paqarta në kërkesat e tyre dhe ato duhet të propozojnë zgjidhje dhe veprime konkrete.

FRYMËZIM

[Shimokawa](#) i vendosur në Hokkaido, Japoni ka për qëllim të përfshijë plotësisht SDG-të në planifikimin e qytetit të tyre. Si hap i parë, qyteti zhvilloi Vizionin Shimokawa 2030, në Mars 2018 (SDG-të e Shimokawas) me pjesëmarrjen e palëve lokale nga fusha të ndryshme. Pjesëmarrësit lokalë, përfshijnë një përfaqësues nga një OJF lokale, një fermer, një mësues, një grua shtëpiake, një drejtues grupi rinor të dhomës së tregtisë lokale, të cilët janë pjesë e procesit për të përfshirë SDG-të në planifikimin e qytetit.⁵

© Shimokawa Town



5 <https://sdgs.un.org/partnerships/incorporation-sdgs-town-planning-development-2030-vision-shimokawa-town-participatory>

FRYMËZIM

Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm në Shqipëri (faqe 17)

[Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm|Kombet e Bashkuara në Shqipëri](#) përmbajnë 17 objektiva që synojnë zhvillimin e qëndrueshëm në dimensione të ndryshme. Strategjia Kombëtare e Zhvillimit të Qëndrueshëm, si një strategji ndërsektoriale, i referohet të gjitha objektivave, por ofron indikatorë të detajuar të përzgjedhur strategjikisht, të lidhur drejtpërdrejt me ndikimin e dëshiruar në përputhje me Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm.



© Federata Shqiptare e Sportit Shkollor



- Bashkitë dhe autoritetet lokale duhet të inkurajojnë evente sportive të gjelbërta dhe kulturore duke i njohur dhe vlerësuar. Kjo do të ishte inkurajuese për organizatat e tjera që të zhvillojnë iniciativa të ngjashme.

FRYMËZIM

Eventi Green në Salzburg⁶: Shteti federal i Salzburgut ofron evente që i kushtojnë vëmendje të veçantë qëndrueshmërisë ekologjike, sociale dhe ekonomike me mundësinë për të bërë pjesë në "Green Event Salzburg". Të gjitha eventet në fushën e kulturës, sportit, fshatit, qytetit dhe festivaleve të klubit kanë mundësi të aplikojnë si pjesë e iniciativës, dhe përfitimet e njohjes variojnë nga zbritjet në kompanitë e përzgjedhura partnere, reklamim falas në faqen e internetit të rajonit dhe udhëzime të drejtpërdrejta si organizohet më mirë eventit pa mbeturina. Një shembull tjetër është përsëri nga Austria: Bashkitë që organizojnë evente në rajonin e Tirolit mund të aplikojnë për certifikata që vërtetojnë referencat e tyre mjedisore dhe zero mbeturina si pjesë e nismës "**Green Events Tirol**"⁷.



© Tanya Pro on Unsplash

6 <https://www.salzburg.gv.at/themen/umwelt/nachhaltigkeit/green-event>

7 <https://www.greenevents-tirol.at/de/>

- Bashkitë mund të kontribuojnë në evente sportive pa mbeturina duke projektuar, rindërtuar ose rinovuar ndërtesat komunale, si qendrat komunitare dhe sportive duke përfshirë qytetarët në procesin e vendimmarrjes. Krijimi i vendit dhe aktivitetet e urbanizmit të ri përqendrohen në dizajnin urban, në shkallë njerëzore ku njerëzit mund të jetojnë jetë të shëndetshme dhe të lumtur.

FRYMËZIM

Krijimi i vendit është procesi i ndërtimit të komuniteteve rreth një vendi dhe duke punuar për të ndërtuar me komunitetet hapësira urbane si vende të ngjashme me shtëpinë. Termi u krijua nga Projekti për Hapësirat Publike (PPS) në New York gjatë viteve 1980. Lutemi zbuloni më shumë [këtu](#). Urbanizmi i ri është stili modern i dizajnit urban që bazohet në urbanizmin e vjetër Evropian dhe fokusohet tek lagjet në shkallë njerëzore, që të krijojnë vende dhe ndërtojë komunitetit⁸. [Këtu](#) jepen shembuj me detaje nga **Bullgaria, Rumania, Spanja dhe Malta** për Krijimin e vendeve dhe Rekreacionin Aktiv (PARK) në kursin e Mësimin Online për të parë bashkëpunimin midis autoriteteve lokale, qytetarëve dhe organizatave sportive bazë në aktivitetet e krijimit të vendeve.



© AJSPT Suceava

8 <https://pressbooks.pub/sustainabilitymethods/chapter/the-role-of-municipalities-in-advancing-sustainability/>

FRYMËZIM

Bashkia e Tiranës, Federata Shqiptare e Sportit Shkollor dhe Shkolla Sabahudin Gabrani po kontribuojnë në realizimin e projektit 'Shkolla si qendër komunitare "Sabahudin Gabrani"'. Objektivi i përgjithshëm i këtij projekti është përdorimi i palestrave dhe hapësirave të tjera të dedikuara të shkollave të ciklit 9-vjeçar dhe atij të mesëm për zhvillimin e aktiviteteve fizike pas orarit mësimor dhe në ditët e pushimit dhe me synimin për edukimin dhe masivizimin e sportit në Tiranë.

<https://fshssh.al/en/events/shkolla-si-qender-komunitare-sabahudin-gabrani/>



© Federata Shqiptare e Sportit Shkollor



Së fundmi, por jo më pak e rëndësishme, bashkitë dhe autoritetet vendore duhet të jenë të vetëdijshëm për rolin e tyre të rëndësishëm për të reduktuar dhe menaxhuar mbeturinat në aktivitete sportive duke⁹:

- + **Përfshirë ofrimin e pajisjeve dhe/ose shërbimeve të riciklimit të mbeturinave, në politikat e eventeve, të tilla si stacionet e ujit, stacionet e biçikletave dhe pajisjet e riciklimit dhe mbeturinave gjatë eventeve.**
- + Miratuar politika të prokurimit publik që i japin përparësi shërbimeve dhe produkteve që RIPËRDOREN brenda eventeve dhe shërbimeve që organizohen dhe sponsORIZOHEN nga komunat.
- + Promovuar alternativa lokale, miqësore ndaj mjedisit si përdorimin e produkteve një përdorim, dhe stimuj ekonomikë që mbështesin dhe i japin përparësi ripërdorimit, dhe bashkëpunimeve me ofruesit lokalë dhe të gjelbërt para, gjatë dhe pas eventeve.
- + Krijuar një strategji komunikimi të përshtatur në nivel lokal që përfshin qëndrueshmërinë mjedisore në eventet lokale dhe duke shpjeguar dhe rritur ndërgjegjësimin se si eventet e gjelbra mund të kontribuojnë për qytetet dhe komunitetet lokale.



© Envercevko

9 <https://wechoosereuse.org/our-demand/>



Rekomandimet e politikave për organizatat e sportit bazë

ndërmarrja e hapave të nevojshëm duke udhëhequr me shembuj

Shpesh, organizatorët e eventeve sportive janë nën presionin e kohës. Papritmas, në të njëjtën kohë ka shumë gjëra për të bërë: përgatitja e letrave, lista me hotele, negocimi me furnitorët dhe shumë detyra të tjera, kështu që ndonjëherë gjatë planifikimit dhe organizimit neglizhohen kriteret mjedisore dhe sociale.

Siç tregohet në udhëzuesin për eventet sportive bazë #WithoutWaste, përdorimi i **6R (Refuzo, Ripërdor, Redukto, Rizëvendëso, Riciklo dhe Rikujto)** është thelbësor në të gjitha fazat e planifikimit të eventeve #WithoutWaste. Ndër këto 6R, veçanërisht dy prej tyre: RIKUJTO dhe RIPËRDOR mund të luajnë një rol efektiv në drejtim të zgjedhjes së ofruesve dhe palëve të interesuara me të cilët organizatat sportive bazë do të bashkëpunojnë gjatë planifikimit të eventeve.

Lista me rekomandime

- Përfshini që në fillim **qëndrueshmërinë në organizimin e eventeve**, në mënyrë që të krijohen kushtet më të mira të mundshme për arritjen e eventeve edhe më të gjelbra. Kontrolloni nëse mund të Refuzoni prodhimin dhe/ose porositjen e materialeve për eventin tuaj. A janë vërtet të nevojshme? Apo vazhdoni ta bëni sepse kështu keni vepruar për një kohë të gjatë? Për shembull, në event shpërndani shishe plastike, materiale promovuese me një përdorim. Krijoni strategji për qëndrueshmërinë mjedisore që mund të aplikoni në eventet që do të organizoni.



© Brands&People on Unsplash

- **Bindni autoritetet lokale dhe bashkitë:** Organizatat sportive bazë mund të diskutojnë idetë mbi eventet e tyre me autoritetet lokale dhe bashkitë që mund të arrijnë, dhe të bindin autoritetet lokale për idenë e organizimit të një eventit sportiv pa mbeturina.

FRYMËZIM SERBI:

Kur organizohet një festival në natyrë zgjidhen vendet që mirëmbahen nga qeveria lokale e atij qyteti të caktuar dhe ku ndodhen kosha për grumbullimin e mbeturinave të veçanta apo një burim uji që do të u shërbejnë nevojave të pjesëmarrësve të festivalit.



© Association Sport for All Serbia



- Bashkëpunimi me palët e duhura të interesit:**
 Organizatat sportive bazë duhet t'u japin përparësi vendeve që janë në gjendje të demonstrojnë qartë ndikimin e tyre pozitiv mjedisor dhe të mbështesin klasifikimin/riciklimin e mbetjeve, dhe të REFUZOJNË të bashkëpunojnë me ofruesit dhe palët e interesuara që nuk janë në përputhje me parimet sport pa mbeturina.

FRYMËZIM

[International Sport and Culture Association](#) (ISCA) zgjodhi 'Maison de la Poste' në Kompleksin 'Tour & Taxi' në Bruksel, si vendin për të organizuar 'MOVE Congress' në 2021. Një nga arsyt kryesore ishte angazhimi për qëndrueshmërinë e 'Tour & Taxi'. "Ne kemi përshtatur mënyrat tona të punës në të gjitha nivelet për t'i dhënë përparësi zhvillimit të qëndrueshëm," shpjegon [Tour & Taxis](#) në faqen e saj të internetit. "Ne konsiderojmë dobinë e objekteve, mënyrën e transportit, zgjedhjen e materialeve, ripërdorimin, përkushtimin ndaj qëndrueshmërisë së organizatorëve të eventeve. Dhe për më shumë jemi duke eksploruar mënyra të reja për të ricikluar materialet e përdorura në të gjithë faqen tonë shumëfunktionale dhe gjithmonë promovojmë përdorimin e produkteve që mund të ripërdoren, riparohen dhe riciklohen."¹⁰ Lexoni më shumë [këtu](#).



© ISCA

10 <https://tour-taxis.com/meet-and-organise/our-commitment/>



- **Monitorimi dhe Vlerësimi:** Është e rëndësishme që organizatat sportive bazë të monitorojnë dhe vlerësojnë eventet e tyre sportive #WithoutWaste. Monitorimi dhe vlerësimi gjatë dhe pas eventeve mund t'i ndihmojë organizatat të masin dhe paraqesin ndikimin e tyre edhe në veprime në shkallë të vogël, dhe t'i inkurajojnë të rrisin ndikimin e tyre në komunitetet dhe mjedisin lokal.
- **Matni dhe vlerësoni ndikimin tuaj:** Disa gjëra mund të bëhen për të demonstruar se edhe veprimet në shkallë të vogël mund të funksionojnë. Një mënyrë e thjeshtë për të mbledhur të dhëna mjedisore gjatë një eventit, është të peshoni sasinë e mbeturinave që devijohen nga vendgrumbullimi i mbetjeve.

FRYMËZIM

Në eventet në Oslo, në kopshtin e Komunitetit Linderud organizatorët kishin caktuar të rinj që qëndronin pranë koshave të mbeturinave për t'i mësuar njerëzit me informacione rreth llojeve të ndryshme të mbeturinave dhe se si t'i ndajnë siç duhet ato. Kjo ishte një mundësi e shkëlqyer arsimore sepse shumë njerëz duan të ndajnë mbeturinat, por janë të paqartë se ku shkojnë mbeturinat e ndryshme! Është gjithashtu një shans për të ndezur diskutime rreth mbetjeve, dhe çfarë është e mundur të riciklohet apo kompostohet në nivel lokal dhe çfarë përfundon gjithsesi në vendgrumbullimin e mbetjeve. Pasi mblodhën të gjitha mbeturinat e eventit, peshuan të gjitha kategoritë e ndryshme në mënyrë që të kuptonin se sa kishin kursyer nga grumbullimi i mbetjeve dhe çfarë përqindje kishin për secilin lloj mbeturine, që në eventin e radhës të përpiqeshin të përmirësonin përqindjen.



© Linderud
Community garden

FRYMËZIM

Programi i Certifikimit të Eventeve të Gjelbërta nga një OJF në Hungari ([Shoqata KÖVET](https://kovet.hu/zold-rendezveny-minosites/)). Organizatat që janë të gatshme të marrin këtë certifikatë duhet të plotësojnë kriteret e 11 temave që lidhen me ndërgjegjësimin mjedisor dhe përgjegjësinë sociale. Do vlerësohen organizatat dhe eventit specifik. Pas përfundimit të vlerësimit dhe kryerjes së një auditimi në vend të eventit, eventit do të vlerësohet në një shkallë me 5 pikë. Nëse plotësohen kriteret, atëherë aplikanti do të marrë titullin 'Event i Kualifikuar i Gjelbër' dhe një certifikatë.¹¹



© Hungarian School Sport Federation

- **Sugjerime konkrete dhe bashkëpunim:** Organizatat sportive bazë mund t'u ofrojnë autoriteteve lokale një listë të iniciativave të gjelbra me të cilat mund të bashkëpunojnë. Duke iu drejtuar autoriteteve lokale me sugjerime konkrete, ju mund t'i bindni ata të sponsorizojnë dhe/ose të mbështesin eventin tuaj në natyrë (duke ofruar kontribut për menaxhimin e mbeturinave, kosha riciklimi etj.)

¹¹ <https://kovet.hu/zold-rendezveny-minosites/>



Frymëzim

RUMANIA:

1. Shoqata 'Green Space Oltenita' organizon aktivitete për kajak, kanoe dhe edukim ekologjik për të gjitha grupmoshat.

<https://asociatiagreenspace.ro/>

<https://www.facebook.com/greenspace.oltanita>

2. Shoqata 'The Act for Tomorrow' përdor burimet e nxjerra kryesisht nga mjedisi i biznesit përmes mikro granteve për zhvillimin e programeve arsimore dhe mjedisore për studentët.

<https://actfortomorrow.ro/contact/>

<https://www.facebook.com/ActforTomorrow>

TURQI:

1. SuCO: Një kompani që ofron një përvojë tjetër me shishe uji për të ndaluar shisheet plastike njëpërdorimshe që mbulojnë botën tonë dhe kanë një jetëgjatësi prej vetëm disa minutash

<https://www.mataramasu.co/>

2. Shoqata 'Bugday': Mbështet një lëvizje ekologjike përmes tregjeve dhe rrjeteve të saj

<https://www.bugday.org/blog/the-bugday-movement/>

3. Kampusi i Gjelbër i Qëndrueshëm në Muğla, Turqi: Ky kampus universitar organizon aktivitete të qëndrueshme të gjelbërta si çiklizmi, simpoziume mbi ndryshimet klimatike etj.

<https://yesilkampus.mu.edu.tr/>



SERBI:

1. Shoqata 'Sport for All Belgrade' organizon çdo vit kampin veror 'Eko' me aktivitete sportive. Ekskursionë në fshatin Rastište, turne rafting, vizitë në HEC Bajina Bašta, xhiro në ekspozitën e Parkut Kombëtar Tara, stërvitje për gjuajtje me hark, volejboll, shigjeta, hedhje patkoi, vozitje, ecje në natyrë, seminare ekologjike dhe grumbullimi i mbeturinave nga pjesa bregdetare e liqenit që kërcënon florën dhe faunën. Mund të gjeni më shumë informacion rreth eventit:
<https://www.sportforall.org.rs/index.php/sr/eko-rekreativni-kamp-tara-2016>
2. Riciklimi i eventit të maratonës
<https://arkfruskagora.org.rs/>

BULLGARI:

'BG Be Active' ftoi bashkitë në Bullgari që t'i bashkohen kauzës mjedisore përmes konkurrencës në nivel kombëtar duke u dhënë komunave këshilla se çfarë hapash të veçantë mund të ndërmarrin për të organizuar evente të gjelbra dhe duke i mbështetur me burime. Bashkitë u inkurajuan të mbledhin mbeturinat veçmas dhe të organizojnë fushata ndërgjegjësuere midis qytetarëve
<https://bgbeactive.org/nadprevara-eko-otgovorna-obshtina-2023/>

HUNGARI:

'National Society of Conservationists', Miqtë e Tokës Hungari kanë programin ÖKOHALÓ që është një edukim mjedisor i qytetarëve, veçanërisht për të rinjtë. <https://mtvsz.hu/okohalo-fenntarthatosagra-nevelesi-intezmenyi-halozat>



Referenca frymëzuese

- 01.** Qëndrueshmeria mjedisore
https://www.sportengland.org/guidance-and-support/facilities-and-planning/sustainability?section=environmental_sustainability_and_active_design
- 02.** Dizajn aktiv
<https://www.sportengland.org/guidance-and-support/facilities-and-planning/design-and-cost-guidance/active-design>
- 03.** Dhjetë parimet e dizajnit aktiv
<https://sportengland-production-files.s3.eu-west-2.amazonaws.com/s3fs-public/2023-05/Document%20%20-%20The%2010%20Principles%20of%20Active%20Design%20-%20Summary.pdf?VersionId=L46MCn5npJtT3qBnoxKm7d5MOYd7hIye>
- 04.** Vendbërja për Rekreacion Aktiv
www.placemakingforactiverecreation.org
- 05.** Udhëzues për ngjarjet për ngjarje të gjelbërta dhe të qëndrueshme
<https://www.dif.dk/raadgivning-og-stoette/idraetsudvikling/baeredygtighed-i-foreninger/baeredygtige-events>
- 06.** Udhëzime frymëzuese: Integrimi i SDG-ve në planin tuaj të politikave shumëvjeçare:
<https://www.local2030.org/library/707/SDGs-in-policy-plan.pdf>
- 07.** Politikat Lokale të Ngjarjeve Sportive dhe Qëndrueshmëria: Një Qasje ndërthurrur:
<https://www.frontiersin.org/articles/10.3389/fspor.2021.667762/full>
- 08.** Çfarë tregon iniciativa "Green Events" nga Austria për prioritizimin e parandalimit të mbetjeve në eventet publike
<https://zerowastecities.eu/what-austrias-green-events-initiative-shows-us-about-prioritising-waste-prevention-in-public-events/>
- 09.** Duke luajtur për Planetin tonë: Si Fitojnë Sportet kur Janë të Qëndrueshëm
<https://greensportsalliance.org/wp-content/uploads/2019/02/Report-PlayingforOurPlanetFINAL-2018-05-02.pdf>
- 10.** Metodat dhe Perspektivat e Qëndrueshmërisë
<https://pressbooks.pub/sustainabilitymethods/chapter/the-role-of-municipalities-in-advancing-sustainability/>



11. Ngjarjet e gjelbërimit: Reduktimi i mbetjeve në Hong Kong
<https://www.wastereduction.gov.hk/en-hk/waste-reduction-programme/greening-your-events>
12. Raporti i Komunave me Gjendje Zero Mbeturina 2022
<https://zerowastecities.eu/wp-content/uploads/2023/02/State-of-Zero-Waste-Municipalities-Report-2022-EN.pdf>
13. Ne zgjedhim faqen e ripërdorimit
<https://wechoosereuse.org/>
14. Udhëzues të Qëndrueshme për Organizimin e Eventeve
https://www.umweltbundesamt.de/sites/default/files/medien/376/publikationen/guidelines_for_the_sustainable_organisation_of_events_bf.pdf
15. Menaxhimi i mbeturinave të komunës, praktika të mira
https://www.csir.co.za/sites/default/files/Documents/Waste_Management_Toolkit_0.pdf
16. Qytetet e Gjelbërta në Evropë
<https://thegreencities.eu/>
17. Qendra sportive të Gjelbërta
https://greensportshub.eu/wp-content/uploads/2023/07/IO5-Recommendations-FINAL_EN.pdf
18. Atletika Botërore
<https://worldathletics.org/athletics-better-world/news/buda-pest-23-study-environmental-health-economic-benefits-active-mobility>
19. Plani i Veprimit i Grupit ITTF për Qëndrueshmërinë (Planet) 2025 dhe planet e veprimit GEDI
<https://www.ittf.com/wp-content/uploads/2023/08/ITTF-GROUP-Sustainability-PAP-2025-1.pdf>
20. Plani i parë i veprimit, Programi Kombëtar për Mbrojtjen e Mjedisit në Serbi
<https://www.ekologija.gov.rs/sites/default/files/2014/11/Nacrt-akcion-og-plana-Nacionalnog-programa-zzs.pdf>
21. Sporti bazë dhe shëndeti planetar - njerëz të shëndetshëm në një planet të sëmurë? nga Karim Abu-Omar
<https://youtu.be/60qfwJxJLr0?feature=shared>

Partnerët

Partneri kryesor:

BG BE ACTIVE

Mbeshtetje financiare:



Organizatrat zbatuese:



Partnerët ekspertë:



KONTAKTET:

BG Be Active Association Bulgaria

www.bgbeactive.org

beactive@bgbeactive.org

DISCLAIMER:

Sport #WithoutWaste (SWW) is funded by the European Union. Views and opinions expressed are however those of the author(s) only and do not necessarily reflect those of the European Union or EACEA. Neither the European Union nor the granting authority can be held responsible for them.